



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1498/5 Prot

Tiranë, më 24/12/2020

VENDIM

Nr. 56, datë 24.12.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1498 Prot., datë 02.12.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet shkresës datë 05.11.2020, depozituar në adresat elektronike [@ishp.gov.al](mailto:@ishp.gov.al), [@shendetesia.al](mailto:@shendetesia.al), [info@shendetesia.gov.al](mailto:info@shendetesia.gov.al), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni, në lidhje me situatën e COVID – 19, si:

1. Numrin e plotë të testeve të bëra në laboratorët private të raportuara në Institutin e Shëndetit Publik që nga fillimi i raportimit të laboratorëve private. Numrin e rasteve pozitive të raportuara nga këto laboratorë në total.
2. Numrin e plotë të testeve të bëra vetëm në laboratorët publikë që nga fillimi i pandemisë. Numrin e rasteve pozitive të raportuara nga këto laboratorë në total.
3. Numrin e personave të izoluar në shtëpi të dyshuar për COVID – 19, por të pa testuar që nga 1 nëntori.

Instituti i Shëndetit Publik, me shkresën nr. 1289/1 Prot., datë 18.11.2020, ka vendosur në dispozicion informacionin në lidhje me pikën 2 të kërkesës së sipërcituar. Gjithashtu, ka sqaruar se: *“Në lidhje me pikën 1, informacioni i plotë gjendet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërsa për pikën 3 informacioni i plotë gjendet pranë Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vijim “OSHKSH”).”*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, dhe nenin 31/1c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit, me e-mail-in datë 04.12.2020, kërkoi të informohet lidhur me trajtimin apo procedurën e ndjekur nga Autoriteti Publik dhe vlerësimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 5448 Prot., datë 10.12.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1498/1 Prot., datë 14.12.2020, ka deleguar për kompetencë dhe trajtim, kërkesën për informacion pranë OSHKSH-së, në lidhje me pikën 3 *“Numrin e personave të izoluar në shtëpi të dyshuar për COVID-19, por të pa testuar që nga 1 nëntori”*.

Ankuesi, pas delegimit të kërkesës, ka vijuar me ankimin nr. 1498/2 prot., datë 16.12.2020, pranë Zyrës së Komisionerit, me pretendimin se: *“...Autoriteti Publik nuk ka njoftuar se çfarë bëhet me pjesën tjetër të kërkesës, konkretisht pyetjen nr. 1. Numrin e plotë të testeve të bëra në laboratorët private të raportuara në ISHP që prej fillimit të raportimit prej laboratorëve privatë dhe Numrin e rasteve pozitive të raportuara nga këto laboratorë në total.”*

Në vijim të ankimit të sipërcituar, me e-mail-in datë 16.12.2020, Zyra e Komisionerit ka kërkuar nga koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik marrjen e masave për trajtimin e kësaj kërkesë dhe vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 5448/1 Prot., datë 11.12.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1498/3 Prot., datë 22.12.2020, ka sqaruar ndër të tjera se: *“...në zbatim të Urdhrit nr. 437, datë 23.07.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes*



*Sociale "Për Miratimin e Procedurës së Kryerjes së testimeve molekulare RT-PCR për Sars-Cov2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë për kryerjen e testimit për nevoja administrative", testimet e kryera nga laboratorët jopublikë të raportuara në ISHP që prej fillimit të raportimit prej këtyre subjekteve përbën 39.8 % të totalit të testimeve të kryera dhe numri i rasteve pozitive/përqindja e pozitivitetit përbën në total përrreth 20 %."*

Duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e sipërcituar, ankuesi ka vijuar me ankimin nr.1498/4 prot., datë 22.12.2020 duke kërkuar ndjekjen e mëtejshme të procedurave në përputhje me LDI, me pretendimin se: *"...Në përgjigjen e Autoritetit Publik, paraqiten të dhëna të pjeshme, që janë të pakuptueshme në këtë formë dhe pa referenca të sakta kohore. Po ashtu përgjigja që është kërkuar në numra të plotë është dhënë si përqindje të një numri që nuk përmendet në informacion. Gjithashtu, referimi i saj te institucionet e varësisë bie ndesh me nenin 12, pika 2 e LDI-së sipas të cilit: "Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar". Autoriteti Publik është institucioni që raporton çdo ditë të dhëna për testimet dhe numrin e të sëmurëve. Ky fakt botërisht i njohur, nënkupton se i gjithë informacioni që kërkohet është në zotërim të tij dhe përgjigjet apo referimet te institucionet e varësisë janë refuzim i kërkesës për informim."*

Komisioneri, pavarësisht vështirësive të hasura për shkak të problematikave të krijuara nga COVID 19, për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor, nuk përjashton në asnjë rast Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Bazuar në sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerëson se, përgjigja e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me kërkesën për informacion të datës 05.11.2020.

Nga hetimi administrativ rezultoi se, në lidhje me pikën e parë të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion informacionin e shprehur në %. Informacioni i dhënë në këtë formë nga Autoriteti Publik nuk është i kuptueshëm, pasi kërkuesi, ka kërkuar të informohet specifikisht mbi *Numrin e plotë të testeve të bëra në laboratorët private të raportuara në ISHP që prej fillimit të raportimit të laboratorëve privatë si dhe numrin e rasteve pozitive të raportuara nga këto laboratorë në total.* Në këtë kuptim, detyrimi për informim lidhur me këtë pikë konsiderohet i papërbushur nga Autoriteti Publik.

Në lidhje me pikën e dytë, të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik citon se me shkresën nr. 1289/1 Prot., datë 18.11.2020 të Institutit të Shëndetit Publik është bërë me dije se kjo pikë është ezauruar nga ky institucion. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, detyrimi për informim konsiderohet i përbushur në lidhje me këtë pikë pasi kërkuesi është njohur me informacionin përkatës.

Në lidhje me pikën e tretë të kërkesës, konstatohet se, Instituti i Shëndetit Publik, me shkresën nr. 1289/1 Prot., datë 18.11.2020, ka sqaruar se informacioni i plotë gjendet pranë OSHKSH-së, fakt ky i konfirmuar edhe nga Autoriteti Publik, i cili e ka deleguar këtë kërkesë nëpërmjet shkresës nr. 5448 Prot., datë 10.12.2020, për kompetencë dhe trajtim, pranë OSHKSH-së, duke kërkuar të vendoset në dijëni në cilësinë e organit epror. Në këto kushte, Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin në kuadër të LDI. Detyrimi për dhënien e këtij informacioni bie mbi OSHKSH në përputhje me nenin 15 të LDI. Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, OSHKSH është autoritet publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se, informacioni i kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion, përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI në të cilën parashikohet se, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*” dhe rrjedhimisht i duhet vënë në dispozicion kërkuarit.

Ekzistenca e informacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të tij kërkuarit.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,



## VENDOSA:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 1498 Prot., datë 02.12.2020 të z. , kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion datë 05.11.2020, konkretisht: (1.Numrin e plotë të testeve të bëra në laboratorët private të raportuara në ISHP që prej fillimit të raportimit të laboratorëve privatë. Numrin e rasteve pozitive të raportuara nga këto laboratorë në total), brenda datës 06 . 01 .2021.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 05.11.2020, konkretisht: (2.Numrin e plotë të testeve të bëra vetëm në laboratorët publikë që nga fillimi i pandemisë. Numrin e rasteve pozitive të raportuara nga këto laboratorë në total. 3.Numrin e personave të izoluar në shtëpi të dyshuar për COVID – 19, por të pa testuar që nga 1 nëntori).
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 24 . 12 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

